



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU, TEHNOLOGIJU I INOVACIJU
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY& INNOVATION**

Prishtinë, 02.09.2021

**Përgjigje në pyetjet e OJQ-ve lidhur me thirrjen publike për ofrimin e mbështetjes
financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore që
mbështesin nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe nxënës të tjerë, që kontribuojnë në
arritjen arsimore**

Pyetje:

Duke u bazuar në thirrjen tuaj publike, menduam të ju drejtohem me një pyetje:

Ne e kemi një OJQ, [REDAKTUAR], jemi të interesuar të fillojmë të punojmë me këto grupet minoritare, mirëpo fatkeqësisht më herët nuk kemi pasur këtë mundësi e sa e pam në thirrje po u kërkojka përvoja dy vjeqare me grupe mësimore e ne kemi vetëm përvojë me shqipëtar dhe jo me grupe minoritare.

Dëshira jonë është që të punojmë me këto grupe në aspektin e edukimit fizik dhe sportiv!

Përgjigje:

Qendrat mësimore kanë për qëllim përmirësimin e rezultateve të të nxënësve dhe pjesëmarrjes në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm, përmes mësimin plotësues dhe mbështetjes për nxënësit rom, ashkali, egjiptian dhe të tjerë.

Bazuar në pyetjen tuaj dhe bazuar në thirrjen publike për ofrimin e mbështetjes financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore që mbështesin nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian si dhe nxënës të tjerë, që kontribuojnë në arritjen arsimore, ju njoftojmë se të drejtë aplikimi kanë të gjitha organizatat joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që menaxhojnë qendrat mësimore, programi i punës së të cilave është i fokusuar në cilëndo nga fushat që lidhen me mbështetjen e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe të cilët dëshmojnë përvojën prej së paku dy vitesh në punën me qendrat mësimore.